



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.377/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjës Vetëvendosje, të paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë.15.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohen** të bazuara ankesat e evidentuara si: Anr.377/2021, Anr.381/2021, Anr.383/2021, Anr.384/2021, Anr.385/2021, Anr.386/2021, Anr.387/2021, Anr.388/2021, Anr.389/2021, Anr.390/2021, Anr.391/2021, Anr.392/2021, Anr.393/2021, Anr.394/2021, Anr.395/2021, Anr.396/2021, Anr.397/2021, Anr.398/2021, Anr.399/2021, Anr.400/2021, Anr.444/2021 të gjitha të datës 14.02.2021, të paraqitura nga subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale. Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 10.750.00 (dhjetë mijë e shtatëqindë e pesëdhjet) euro, dhe detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të dënimit shtesë**.

## A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.377/2021, Anr.381/2021, Anr.383/2021, Anr.384/2021, Anr.385/2021, Anr.386/2021, Anr.387/2021, Anr.388/2021, Anr.389/2021, Anr.390/2021, Anr.391/2021, Anr.392/2021, Anr.393/2021, Anr.394/2021, Anr.395/2021, Anr.396/2021, Anr.397/2021, Anr.398/2021, Anr.399/2021, Anr.400/2021, Anr.444/2021, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në të cilat pretendon se anëtari i kryesisë së subjektit politik AAK, Naim Arifi, ka bërë postimin dhe shpërndarjen e kandidatëve për deputet Faton Jakupi, Ahmet Isufi, Rexhep Kadriu, Diana Kryeziu, si dhe fletvotimin me numër të partisë, në story në rrjetin social në Facebook. Gjithashtu në ankesat e tjera të cekura me lartë ka theksuar se përmes Facebook - Instagram, në llogarinë zyrtare në facebook të subjektit AAK dhe në llogaritë zyrtare në Facebook - Instagram të kandidatëve për deputet dhe përkrahësve nga radhët e këtij subjekti politik, respektivisht për kandidatët: Haxhi Shala, Diellza Kukaj, Teuta Haxhiu, Fatos Berisha, Greta Daci, Marqe Tanushi Selmanaj, Burbuqe Bakija Deva, Ukë Osaj, Xhavit Zariqi, Shkumbin Demaliaj, Bajram Kastrati, Ali Berisha, Rustem Berisha, Pal

Lekaj, Lahi Brahimaj, Hamdi Bytyqi, Ali Berisha, Arif Ahmetxhekaj dhe faqja në fb. me emrin Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë bërë fushatë në rrjetin social Facebook, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale dhe CD.

Në përgjigjet në ankesë sa i përket sa i përket ankesës 377/2021, nuk qëndrojnë pretendimet se personi me emrin Naim Arifi është anëtar i kryesisë së subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ky subjekt ka kryesin e saj prej 78 antarëve të publikuar në web faqen zyrtare të saj <https://aak-ks.com/kryesia>, mirëpo Naim Arifi nuk është anëtarë i kryesisë së partisë siç pretendon ankuesi. Prandaj duke marrë parasysh se personi në fjalë nuk është anëtarë i kryesisë së AAK, sic pretendon ankuesi, konsiderojmë se nuk ka asnjë shkelje të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme neni 36 par.1 pika b, e aq më pakë të nenit 8 par.1, pika c) të rregullës zgjedhore 13/2012 të KQZ. Po ashtu nuk shihet data e këtij postimi nëse më të vërtetë është bërë me datë 13 shkurt sic pretendon ankuesi.

Ndërsa për ankesat e tjera që janë të bashkuara në këtë vendim, me përjashtim të ankesës 377/2021, për të gjitha e ka bërë përgjigjen e njëjtë, me të cilën ka theksuar se propozojm fillimisht PZAP, të shqyrtoj afatshmërinë e ankesave pasi që nuk është e çartë se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti AAK. Po ashtu kontestojmë në tërësi pretendimet e Vetvendosjes, e cila në vazhdimësi ka keqpërdorur të drejtën për ushtrimin e ankesave. Kjo për faktin se nga CD, e bashkangjitura qartë shihet se asnjë postim nuk është bërë me datë 13 apo 14 Shkurt, por janë postime të mëhershme. Po ashtu postimet që i kanë bërë kandidatët në faqet e tyre kanë të drejtë që të mbesin të publikuara por publikimet e reja janë të lejuara. Prandaj me qenëse nuk kemi të bëjmë me publikim të datës 13 apo 14 Shkurt, ankesa është në tërësi e pa bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet. Ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e Vetëvendosje me të cilën ka kërkuar që të ndërmeren veprime ligjore ndaj subjektit AAK.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive – CD të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.377/2021, Anr.381/2021, Anr.383/2021, Anr.384/2021, Anr.385/2021, Anr. 386/2021, Anr.387/2021, Anr.388/2021, Anr.389/2021, Anr.390/2021, Anr.391/2021, Anr.392/2021, Anr.393/2021, Anr.394/2021, Anr.395/2021, Anr.396/2021, Anr.397/2021, Anr.398/2021, Anr.399/2021, Anr.400/2021, Anr.444/2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri

bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidatët për deputetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e këtij subjekti, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social Facebook - Instagram kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti politik AAK, dhe kandidatët e saj, të apostrofuuar në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut - Instagram, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, në gjithsej 21 shkelje, të cilat promovojnë subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, se pretendimet e palës ankues se personi me emrin Naim Arifi, nuk është antarë i kësaj partije, këto pretendime Paneli i vlerësoi si jo relevante për vendosje në këtë çështje, për faktin se reklamimet kanë qenë për kandidatët për deputet të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i njëjti është bërë nga përkrahës të kësaj partije dhe si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Aleanca për ardhmërinë e Kosovës se ankesat e subjektit politik Vetvendosje, janë të pas afatshme, këtë pretendim paneli e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret ankesat nga subjekti politik Vetvendosje janë bërë brenda ditës së heshtjes zgjedhore, përkatësisht me 14.02.2021, ditën e zgjedhjeve dhe nga verifikimi që ka bërë paneli ka rezultuar që të njëjtat postime të paraqitura në ankesë kanë qenë ende aktive në rrjete sociale Facebook-ut – Instagram dhe nga kjo rezulton se pretendimi për afatshmëri është i pa bazuar.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, se postimet janë bërë më herët dhe jo me datë 13 apo 14 Shkurt, dhe se të njëjtat kanë të drejtë të shfaqen nëse janë të postuara më herët, këto pretendim Paneli, i vlerëson si të pa bazuara. Në këtë rast kemi të bëjmë me kandidatët për deputet që kanë postime aktive gjatë datës 13 dhe 14 Shkurt dhe të njëjtat kanë qenë të sponsorizuara, datë e cila është heshtje zgjedhore. Me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër, andaj në këtë rast sponsorizimi i postimeve për shfaqje publike në rrjete sociale edhe për datat 13 dhe 14, është shkelje e heshtjes zgjedhore, prandaj ankesat e subjektit politik Vetvendosje janë pranuar si të bazuara.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), është përgjegjës për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartëcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.377/2021 më datë 15.02.2021

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Zhafëri**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.